



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 25.03.2025

Numër Protokolli:

A.nr.287/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.287/2025 të datës 07.02.2025 të parashtruar nga ankuesi E.T, kundër organit të punësimit Ministria Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.03.2025 mori:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.287/2025 e datës 07.02.2025 e parashtruar nga ankuesi E.T.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i datës 17.01.2025 për kandidatin fitues për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil E.T (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 07.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 893/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor lidhur me konkursin me emrin e grupit, grupi i administrimit të përgjithshëm për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, i njëjti thekson se i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranim dhe i është bërë e padrejtë, vlerësoj që komisioni është ndikuar politikisht gjatë vlerësimit të

intervistës kërkon që ti shqyrtohet ankesa dhe të bëhet vlerësim real pasi që ndihem i dëmtuar si palë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.02.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa Këshilli më datë 24.02.2025, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 893/2025 të datës 07.02.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Letërnjoftim i E.T.; Njoftim i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i datës 17.01.2025 për kandidatin fitues për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Konkurs me emrin e grupit, grupi i administrimit të përgjithshëm për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër reference RN00015734 i datës 05.11.2024; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 14.02.2025; Përgjigje në ankesë i datës 24.02.2025; E-mail nga H.K. për B.Z. i datës 14.02.2025; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për M.L. i datës 17.01.2025; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për E.T. i datës 17.01.2025; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga simbnj; Pyetjet në intervistë me gojë; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga B.K. për M.L. i datës 15.01.2025; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga B.K. për E.T. i datës 15.01.2025; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga F.I. për M.L. i datës 15.01.2025; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga F.I. për E.T. i datës 15.01.2025; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga H.K. për M.L. i datës 15.01.2025; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga H.K. për E.T. i datës 15.01.2025; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga A.P. për M.L. i datës 15.01.2025; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga A.P. për E.T. i datës 15.01.2025; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga B.C. për M.L. i datës 15.01.2025; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga B.C. për E.T. i datës 15.01.2025; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për E.T. i datës 13.01.2025; Njoftim nga DBNJ i MMPHI i datës 10.01.2025; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për M.L. i datës 13.01.2025; Formular i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit kodi CN9945; Formular i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit kodi CN9883; Testimi Elektronik kandidati CN9945; Testimi Elektronik kandidati kodi CN9883; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për M.L. i datës 26.12.2024; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për E.T. i datës 26.12.2024; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për E.T. i datës 19.12.2024; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për M.L. i datës 19.12.2024; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit B.K. i datës 07.03.2018; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit A.P. i datës 03.10.2019; Akt Emërim i H.K. i datës 13.12.2022; Akt Emërim i F.I. i datës 19.05.2014; Vendim për transferimin e përhershëm për interes të institucionit nga zv. Drejtori i AMMK

për B.C. i datës 16.11.2023; Vendim për formimin e komisionit të pranimit i AMMMK i datës 20.12.2024; Lista e aplikantëve nga simbnj; Njoftim i DBNJ MMPHI kandidatët që i plotësojnë kriteret i datës 18.12.2024; Lista e aplikantëve nga simbnj; Aplikacioni i M.L. i datës 21.11.2024; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme të përgjithshme Gjinnazin shm Ulpiana në Lipjan e M.L. me numër protokollit 9-01-06-1991 i datës 04.06.1991; Vërtetim nga DBNJ MMPHI për M.L. i datës 20.11.2024; Letërnjoftim i M.L.; Pasqyra e llogarisë së trustit e M.L. i datës 01.08.2002-08.11.2024; Aplikacioni i E.T. i datës 21.11.2024; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme të përgjithshme Gjinnazin shm Ulpiana në Lipjan e E.T. me numër protokollit 33/643 i datës 06.06.1997; Referencë nga AKMM për E.T. i datës 20.02.2018; Marrëveshja për shërbime speciale e E.T. i datës 12.12.2016; Marrëveshja për shërbime speciale e E.T. i datës 12.02.2017; Marrëveshja e mirëkuptimit për praktikë në punë i E.T. i datës 03.05.2024; Letërnjoftim i E.T.; E-mail nga V.T. për F.I. i datës 05.11.2024; Formulari i përshkrimit të punës për pozitën Ciceron; E-mail nga A.P. për F.I. i datës 01.11.2024; E-mail nga H.K. për F.I. i datës 30.10.2024; E-mail nga A.B. për H.K. i datës 30.10.2024; E-mail nga H.K. për A.B. i datës 30.10.2024; E-mail nga A.F. për H.K. i datës 24.10.2024; E-mail nga H.K. për A.F. i datës 24.10.2024; E-mail nga H.K. për A.F. i datës 30.09.2024; E-mail nga H.K. për F.I. i datës 30.10.2024; E-mail nga A.B. për H.K. i datës 30.10.2024; E-mail nga H.K. për A.B. i datës 30.10.2024; E-mail nga A.F. për H.K. i datës 24.10.2024; E-mail nga H.K. për A.F. i datës 24.10.2024; E-mail nga H.K. për A.F. i datës 30.10.2024;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit, është e pa bazuar, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 05.11.2024 ka shpallë Konkursin me numër reference RN00015734 me emrin e grupit, grupi i administrimit të përgjithshëm për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan klasa e pozitës profesional 3, ku afati për aplikim ka qenë nga data 06.11.2024 deri më 05.12.2024. Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi me datë 21.11.2024 i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke plotësuar kriteret e konkursit dhe se i është nënshtruar fazës së testimit me shkrim të mbajtur me datë 30.12.2024, ku në testin me shkrim për grupin e administrimit të përgjithshëm për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka marrë gjithsejtë 58.8 pikë nga rrjedh se ankuesi ka marrë pikët e mjaftueshme për t'iu nënshtruar fazës tjetër të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë i cili në intervistë ka marrë gjithsejtë 17.8 pikë. Ndërsa sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve del se ankuesi ka marrë pikët totale gjithsejtë 76.6 pikë për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan duke u renditur i dyti.

Ndërsa sipas shkresave të lëndës rezulton në këtë konkurs ka aplikuar kandidati M.L. me datë 21.11.2024 i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke plotësuar kriteret e konkursit dhe se i është nënshtruar fazës së testimit me shkrim të mbajtur me datë 30.12.2024, ku në testin me shkrim për grupin e administrimit të përgjithshëm për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së

Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka marrë gjithsejtë 58.8 pikë nga rrjedh se ka marrë pikët e mjaftueshme për t'iu nënshtruar fazës tjetër të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë i cili në intervistë ka marrë gjithsejtë 21 pikë. Ndërsa sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve del se ka marrë pikët totale gjithsejtë 79.8 pikë për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan duke u renditur i pari.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 17.01.2025 ka publikuar Njoftimin për kandidatin fitues për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan për kandidatin M.L. me gjithsejtë 79.8 pikë.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor lidhur me konkursin me emrin e grupit, grupi i administrimit të përgjithshëm për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i njëjti thekson se i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranimit dhe i është bërë e padrejtë, vlerësoj që komisioni është ndikuar politikisht gjatë vlerësimit të intervistës kërkon që ti shqyrtohet ankesa dhe të bëhet vlerësim real pasi që ndihem i dëmtuar si palë.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN00015734 për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe si rrjedhojë konstatoi se si kriteret të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e shkollës së mesme apo ekuivalente me të, Arsim i mesëm i paspecifikuar. **Përvoja e punës e kërkuar:** Nuk kërkohej.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave fillimisht ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Po ashtu Kolegji i Këshillit ka analizuar dosjen e kandidatit fitues M.L. dhe ka konstatuar se i njëjti i ka plotësuar kriteret lidhur me arsimimin e kërkuar si dhe përvojën e punës ashtu siç ka qenë e përcaktuar me konkurs për pozitën e lartcekur.

Kolegji i Këshillit, në përmbushje të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil, fillimisht ka analizuar aktin e themelimit të Komisionit të pranimit, gjegjësisht vendimin me numër Ref.146/AMMK/2024 të datës 20.12.2024 nga analizimi i të cilit ka gjetur se Komisioni i pranimit për pozitën e kategorisë profesionale 3 të grupit të administrimit të përgjithshëm është në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, anëtari B. K. në pozitën e punës Drejtor i Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar Sharri në Departamentin Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, anëtarja A.P. në pozitën e punës Udhëheqëse e Sektorit për Monumentin me Rëndësi të Veçanta në Departamentin Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, anëtari H.K. në pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për mbikqyrje dhe kontroll në Agjencionin për Mbrojtjen e

Mjedisit të Kosovës, anëtarja F.I. në pozitën e punës Zyrtare e Lart e Personelit në sektorin Divizioni i Burimeve Njerëzore si dhe anëtari B.C. në pozitën e punës Zyrtar për projekte në sektorin për Raportim Mjedisor dhe Bashkëpunim në Drejtorinë e vlerësimit të Gjendjes së Mjedisit. Kolegji i Këshillit konstaton se pozita Ciceron, klasifikohet si kategori profesionale sic përcaktohet me nenin 38 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, andaj edhe Komisioni i pranimit duhet të jetë në përbërje siç kërkohet me nenin 40 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale..., dhe si rrjedhojë bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se përbërja e komisionit të pranimit në procedurën përkatëse të rekrutimit ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore.*

Referuar kuadrin ligjorë si më lartë, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dosjen e kandidatit M.L., të shpallur fitues dhe si rrjedhojë ka gjetur se i njëjti posedon Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme të përgjithshme Gjinnazin shm Ulpiana në Lipjan drejtimi Natyror matematikor me numër protokollit 9-01-06-1991 të datës 04.06.1991, me përvojë pune si në vijim sipas vëtetimit të datës 20.11.2024 të lëshuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nga data 21.05.2018 deri 20.10.2018 ka qenë në pozitën Roje Sigurimi në Shpellën e Gadimes, po ashtu posedon pasyren e llogarisë së trustit.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe vlerësimit të ligjshmërisë së procedurës përkatëse të rekrutimit për këtë pozitë, ju referua legjislacionit në fuqi, konkretisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë nenit 39 paragrafi 7 ku përcaktohet se: *7.Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8.Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. **Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës**”, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht: **Nenit 9** ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë,**

aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse.

3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishhtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishhtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. Ndërsa neni 10 i po kësaj rregullore përcakton se: 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashatrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të

gjithë anëtarëve. Si dhe neni 11 i cili përcakton se: 1.Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2.Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat. Andaj si rrjedhojë e kësaj pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në kuadrin ligjor përkatës, dhe nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se në Konkursin me numër reference RN00015734 të datës 05.11.2024, në kuadër të cilës procedurë ka aplikuar edhe ankuesi, testimi me shkrim ashtu sikurse edhe vlerësimi i kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është realizuar në mënyrë elektronike. Pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për kandidatët dhe janë të zgjedhura nga banka e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Tutje, nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi në fazën e testimit me shkrim ka arritur t'i mbledhë gjithsejtë 58.8 pikë për pozitën e punës Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nga rrjedh se ankuesi ka marrë pikët e mjaftueshme për t'iu nënshtruar fazës tjetër të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë i cili në intervistë ka marrë gjithsejtë 17.8 pikë në total gjithsejtë 76.6 pikë duke u renditur i dyti. Ndërsa sipas shkresave të lëndës rezulton se kandidati fituese M.L. në fazën e testimit me shkrim ka arritur t'i mbledhë gjithsejtë 58.8 pikë për pozitën e punës Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ndërsa në intervistë ka marrë gjithsejtë 21 pikë në total gjithsejtë 79.8 pikë duke u renditur i pari. Si rrjedhojë i njëjti ka fituar të drejtën për emërim në shërbimin civil, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rastin e shpalljes së njoftimit të datës 17.01.2025 për kandidatin fitues për pozitën Ciceron në Gadime Lipjan në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër reference RN00015734, ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plot gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që për sa më sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.287/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit E.T;
- Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.